



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE  
BORDI

VENDIM

Nr. 102, Datë 16.04.2021

MBI

**MOS FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT TË SHOQËRISË OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT SH.A., PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË BALANCIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 19, 62, 98, 99 dhe 100, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe neneve 15, 19 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, nenit 3, pika 3.3, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 02.07.2020, bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 16.04.2021, mbasi shqyrtoi propozimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., për disa ndryshime në Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”,

**Konstatoi se:**

- OST sh.a., me shkresën nr.1384 prot., datë 25.02.2021, ka paraqitur Raportin e vlerësimit lidhur me zbatimin e Rregullave të Mekanizmit Balancues për muajin Janar 2021, ku ndër të tjera propozon disa ndryshime në Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike dhe anekset përkatëse, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 02.07.2020.
- Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 02.07.2020 parashikojnë që Rregullat mund të ndryshohen bazuar në shkaqe të argumentuara nga ana e OST sh.a. Propozimet e përcjella përmes shkresës nr.1384 prot., datë 25.02.2021, si ato që lidhen me formën e dokumentit dhe ato që lidhen me përmbajtjen e tij nuk janë shoqëruar me argumentimet përkatëse ku të evidentohet nevoja për kryerjen e ndryshimit të kërkuar.
- Propozimet e përcjella nuk përmbushin detyrimet që rrjedhin nga pika 3.3, e nenit 3 (Miratimi dhe Rishikimi), të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike. OST sh.a., në cilësinë e propozuesit të ndryshimeve të këtij dokumenti duhet të krijonte një Komitet përgjegjës për ndryshimin e Rregullave, i cili inicion ndryshimin e

tyre. Ky ndryshim i propozuar, në vijim paraqitet zyrtarisht nga Ost për miratim të ERE-s. |

- Me shkresën nr.1384/2 prot., datë 18.03.2021, në përgjigje të shkresës së ERE nr. 397/1 prot., datë 09.03.2021, OST sh.a., ka bërë me dije se, citojmë “*Nuk ka hapur procedurë konsultative me palët e interesit dhe Sekretariatit e Energjisë*” sa i përket propozimeve për ndryshim në Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.
- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 89, datë 31.03.2021 «Mbi propozimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., “Për rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike nga data 1 Prill 2021”», është vendosur tashmë nisja e efekteve financiare të rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 106, datë 02.07.2020, “Mbi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” për palët përgjegjëse për balancim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Mos fillimin e procedurës për shqyrtimin e propozimit të shoqërisë OST sh.a., për disa ndryshime në “Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 106, datë 02.07.2020.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë shoqërinë OST sh.a., mbi vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**